

VENDIM
Nr.822, datë 5.12.2007

**PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE,
FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali” të emërtohet Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.
 2. Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë:
 - a) Krijohet Fakulteti i Edukimit, i cili të ketë në përbërje:
 - Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Mësuesisë;
 - Departamentin e Formimit të Përgjithshëm, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Mësuesisë;
 - Departamenti i Gjuhëve të Huaja, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Gjuhëve të Huaja.
 - b) Fakulteti i Tregtisë të emërtohet Fakulteti i Ekonomisë dhe i Drejtësisë, i cili të ketë në përbërje këto departamente:
 - Departamentin e Biznesit;
 - Departamentin e Turizmit;
 - Departamentin e Drejtësisë.
 - c) Fakulteti i Marinës të emërtohet Fakulteti i Shkencave Teknike, i cili të ketë në përbërje këto departamente:
 - Departamentin e Inxhinierisë Navale;
 - Departamentin e Lundrimit;
 - Departamentin e Teknologjisë së Informacionit.
 - ç) Fakulteti i Infermierisë shkrihet dhe organizohet në Departament të Infermierisë, që varet nga rektorati i Universitetit.
 3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.
 4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha